

Pyetjet e shpeshta në Departamentin e Statistikës

Përmbajtja

1. Cili është roli dhe funksioni i Departamentit të Statistikës?
2. Cilët sektorë përfshihen në statistikat e publikuara nga Departamenti i Statistikës?
3. Cila është baza ligjore që obligon BQK-në të publikoj statistikat monetare, financiare dhe të sektorit të jashtëm?
4. Çfarë metodologjie përdoret për përpilimin e këtyre statistikave?
5. Cila është frekuenca e publikimit të statistikave monetare dhe financiare dhe të sektorit të jashtëm?
6. A publikohet ndonjë nga këto të dhëna në nivel të individëve ose entiteteve juridike?
7. A publikohet ndonjë informacion lidhur me metodologjinë e përpilimit të statistikave?
8. Ku mund të gjejë të dhënat për të gjithë sektorët e ekonomisë?
9. Çfarë nënkuptohet me statistikat monetare dhe financiare dhe cilët tregues kryesor përfshijnë këto statistika?
10. Cili është burimi i të dhënave për përpilimin e statistikave monetare dhe financiare ?
11. Çfarë nënkuptojmë me korporata tjera depozituese?
12. Cilët statistikat përfshihen në nën sektorët e korporatave financiare, korporatave depozituese , korporatave tjera depozituese dhe korporatave tjera financiare?
13. Ku mund të gjejë statistikat bankare?
14. A publikon BQK të dhëna për normat e interesit në kredi dhe depozita dhe ku mund t'i gjej ato?
15. Përveç KTD-ve, cilat institucione merren me lejimin e kredive?
16. Cili është aktiviteti i ndihmësve financiar?
17. Ku mund të gjejë të dhëna për numrin e policave të sigurimit?
18. Çfarë nënkuptohet me statistikat të sektorit të jashtëm dhe cilët tregues kryesor përfshijnë këto statistika?
19. Cili është kriteri për të klasifikuar statistikat në kuadër të sektorit të jashtëm?
20. Çka nënkuptohet me rezidentë të Kosovës?
21. Cili është burimi i të dhënave për përpilimin e statistikave të sektorit të jashtëm?
22. Çfarë nënkupton deficioni i llogarisë rrjedhëse të Bilancit të Pagesave të Kosovës?
23. Cili është burimi i të dhënave për përpilimin e statistikave të tregtisë së jashtme në mallra dhe pse vlera e këtyre statistikave të publikuara nga BQK dallon nga ato të publikuara nga ASK?
24. Cili institucion është prodhues zyrtar i statistikave mbi remitancat në Kosovë dhe çfarë burime të të dhënave përdoren për të përpiluar ato?
25. Cili institucion është prodhues zyrtar i statistikave mbi Investimet e Huaja Direkte në Kosovë (IHD) dhe çfarë metodologjie përdoret për përpilimin e tyre?
26. Çfarë nënkupton zëri “Gabimet dhe harresat neto” në kuadër të bilancit të pagesave?
27. Çfarë tregojnë statistikat për PIN (Pozicioni i Investimeve Ndërkombëtare)?

28. Çka përfshihet në statistikat e borxhit të jashtëm të publikuara nga BQK?
29. Ku duhet të drejtoheni për informata shtesë?

1. Cili është roli dhe funksioni i Departamentit të Statistikës?

Departamenti i Statistikës (DS) është njësi organizative në kuadër të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), i cili është përgjegjës për mbledhjen, përpilimin dhe publikimin e statistikave të sektorit monetar dhe financiar dhe të sektorit të jashtëm të Kosovës. Detyrat dhe përgjegjësitë e DS-së derivojnë nga detyrat dhe funksionet e BQK-së. DS është i përkushtuar të ofroj informata cilësore përmes publikimeve periodike dhe jo-periodike në funksion të realizimit të objektivat të BQK-së si dhe për nevoja të publikut të gjerë. Për më tepër rreth DS-së ju lutem vizitoni këtë adresë: <https://bqk-kos.org/?id=9>

2. Cilët sektorë përfshihen në statistikat e publikuara nga Departamenti i Statistikës?

Departamenti i Statistikës është njësi kryesore organizative përgjegjëse për mbledhjen, përpilimin dhe publikimin e Statistikave të Sektorit Monetar e Financiar, si dhe Statistikave të Sektorit të Jashtëm të ekonomisë së Kosovës.

3. Cila është baza ligjore që obligon BQK-në të publikoj statistikat monetare dhe financiare dhe të sektorit të jashtëm?

Një nga detyrat e Bankës Qendrore në përmbushjen e objektivave të saj është mbledhja dhe publikimi i statistikave. Kjo është e definuar në nenin 8 të [Liqjit Nr. 03/L-209 Për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës](#). Përgjegjësia e BQK – së për mbledhjen dhe publikimin e statistikave është e rregulluar edhe me rregullore mbi informacionin statistikor. Respektivisht, (1) [Rregulloren mbi Statistikat Monetare-Financiare dhe Llogaritë financiare](#); (2) [Rregulloren mbi Statistikat e Bilancit të Pagesave dhe Pozicionit të Investimeve Ndërkombëtare](#); dhe (3) [Rregulloren mbi Statistikat e Instrumenteve të Pagesave](#)). Rrjedhimisht, rregulloret definojnë raportuesit, obligimet statistikore të raportuesve, periudhën e raportimit, raportet statistikore si dhe konfidencialitetin.

4. Çfarë metodologjie përdoret për përpilimin e këtyre statistikave?

Përpilimi i statistikave monetare, financiare dhe të sektorit të jashtëm bëhet në përputhje me standardet dhe praktikat ndërkombëtare, respektivisht me Manualin dhe Udhëzuesin për përpilimin e Statistikave Monetare dhe Financiare (IMF, 2016), Manualin mbi Statistikat e Normave të Interesit (ECB, 2017), Sistemin e Llogarive Kombëtare (SNA 2008), Sistemi Evropian i Llogarive Kombëtare dhe Regjionale (ESA 2010), Manuali mbi Statistikat e Bilancit të Pagesave dhe Pozicionit të Investimeve Ndërkombëtare (FMN 2009), Udhëzuesi mbi Statistikat e Bilancit të Pagesave dhe Pozicionit të Investimeve Ndërkombëtare (FMN, 2014), Udhëzues për përpilimin e borxhit të jashtëm (FMN, 2014), dhe një numër të gjerë të manualeve tjera specifike për fusha të caktuara.

5. Cila është frekuenca e publikimit të statistikave monetare dhe financiare dhe të sektorit të jashtëm?

Statistikat monetare dhe financiare publikohen në periodicitet mujore me afatin $t + 25$, që nënkupton 25 ditë pas përfundimit të muajit referuese. Statistikat e bilancit të pagesave publikohen gjithashtu me periodicitet mujor, mirëpo me afatin $t + dy\ muaj$ pas përfundimit të muajit referues. Kurse statistikat e pozicionit të investimeve ndërkombëtare dhe të borxhit të jashtëm publikohen në periodicitet tremujor,

në afatin t + tre muaj pas përfundimit të tremujorit referuese. Kjo praktikë e publikimeve është konsistent me [kalendarin e publikimeve](#).

6. [A publikohen ndonjë nga këto të dhëna në nivel të individëve ose entiteteve juridike?](#)

Departamenti i Statistikës publikon vetëm statistikat të agreguara. Zakonisht në përputhje me standardet ndërkombëtare (manualët e sipërpërmendur), sipas klasifikimeve të ndryshme, por asnjë nga këto të dhëna nuk publikohet në nivel të individëve ose entiteteve juridike. Rrjedhimisht, BQK në pajtim me ligjin e lartë përmendur dhe rregulloret mbi informacionin statistikor, respekton maksimalisht parimin e konfidencialitetit në statistikat e publikuara.

7. [A publikohet ndonjë informacion lidhur me metodologjinë e përpilimit të statistikave?](#)

BQK, përveç të dhënave statistikore ofron informacion edhe për metodologjinë e përpilimit të statistikave që janë në përgjegjësi të saj. Për më tepër rreth metodikës së statistikave monetare, financiare, klikoni [këtu](#). Rreth metodikës së përpilimit të Statistikave të Bilancit të Pagesave kliko [ketu](#).

8. [Ku mund të gjejë të dhënat për të gjithë sektorët e ekonomisë?](#)

BQK publikon një faqe me informata statistikore për indikatorët kryesor të ekonomisë së Kosovës. Kjo faqe është emëruar "[Ekonomia e Kosovës në një shikim](#)", me që përmban një pasqyrë të shkurtër të indikatorëve kyç ekonomikë. Indikatorët kryesor të përfshirë në këtë faqe janë: produkti i brendshëm bruto, çmimet, tregun e punës, sektorin e jashtëm, kursin e këmbimit, normën e interesit, kreditë, financat qeveritare dhe popullsinë. Të dhënat e publikuara janë në formë tabelore dhe grafike, dhe ofrojnë mundësi lidhje me faqet kryesore ku publikohen të dhëna analitike për gjithsecilin indikator.

Një faqe tjetër që përmbanë indikatorë kryesor të ekonomisë është [Faqja Përmbledhëse e të Dhënave Kombëtare](#). BQK është koordinatore e vendit në kuadër të programit Sistemi i Avancuar i Shpërndarjes së të Dhënave të Përgjithshme të FMN-së (e-GDDS – Enhanced General Data Dissemination System). Rrjedhimisht, BQK bën grumbullimin e të dhënave për të gjithë sektorët e ekonomisë nga institucionet relevante që i përpilojnë ato të dhëna dhe i publikon në afatin e paraparë. Të dhënat e publikuara në kuadër të GDDS mund t'i gjeni në këtë [adresë](#).

9. [Cfarë nënkuptohet me statistikat monetare dhe financiare dhe cilët tregues kryesor përfshijnë këto statistika?](#)

Statistikat monetare dhe financiare tregojnë raportet e sistemit financiar me ekonominë e brendshme dhe pjesën tjetër të botës.

Statistikat monetare nënkuptojnë të dhëna rrjedhëse dhe të akumuluar për asetet dhe detyrimet e sektorit të korporatave financiare të një ekonomike, dhe përfshijnë këta tregues kryesor: pasqyrën e korporatave financiare, pasqyrën e korporatave depozituese, pasqyrën e bankës qendrore, pasqyrën e korporatave tjera depozituese, etj. *Statistikat financiare* nënkuptojnë të dhëna rrjedhëse dhe të akumuluar për të gjithë sektorët e ekonomisë duke përfshirë këta tregues: bilancin e gjendjes dhe pasqyrën e të ardhurave të korporatave tjera depozituese, bankës qendrore, korporatave depozituese, fondeve pensionale, kompanive të sigurimit, ndihmësve tjerë financiar, etj.

10. [Cili është burimi i të dhënave për përpilimin e statistikave monetare dhe financiare?](#)

Për shkak të natyrës së statistikave të sektorit monetar dhe financiar, burimet e të dhënave për përpilimin e tyre janë institucionet financiare që operojnë në Kosovë, respektivisht Banka Qendrore, korporatat tjera

depozituese (bankat komerciale), ndërmjetësit tjerë financiar (institucionet mikorfinanciare), ndihmësit financiar, fondet pensionale, kompanitë e sigurimeve etj. Të dhënat nga këto institucione sigurohen nga pasqyrat gjithë përfshirëse (survey) dhe pasqyrat financiare (bilanci i gjendjes dhe pasqyra e suksesit).

11. [Cfarë nënkuptojmë me korporata tjera depozituese?](#)

Korporatat tjera depozitues (KTD) në statistikën e publikuar nga BQK nënkuptojnë bankat komerciale, mirëpo është term më i gjerë sepse përfshinë edhe Fondet në Tregut të Parave (anglisht: Money Market Funds). Për momentin, në Kosovë nuk kemi Fonde në Tregun e Parave, mirëpo për të qenë konsistent në metodologjinë me vendet e tjera përdoret termi KTD. Përdorimi i termit të KTD-ve është konsistent me standardet ndërkombëtare (manualët e përmendura më lartë).

12. [Cilët statistikat përfshihen në nën sektorët e korporatave financiare, korporatave depozituese, korporatave tjera financiare dhe korporatave tjera depozituese?](#)

Në nën sektorin e korporatave financiare përfshihen të gjitha institucionet financiare që operojnë në Kosovë; në nën sektorin e korporatave depozituese hyjnë Banka Qendrore dhe korporatat tjera depozituese; dhe, në nën sektorin e korporatave tjera financiare hyjnë kompanitë e sigurimeve, fondet pensionale, ndërmjetësit tjerë financiar dhe ndihmësit financiar.

Sa është numri i depozitave në Kosovë?

Ju informojmë që informatat rreth depozitave mund t'i gjeni në linkun në vijim: <https://www.bqk-kos.org/?id=55>, gjithashtu për më shumë informata i referoheni raporteve apo publikimeve tjera të cilat gjenden në faqen zyrtare të BQK-së www.bqk-kos.org

13. [Ku mund të gjejë statistikat bankare?](#)

Statistikat për bankat komerciale publikohen në kuadër të Serive Kohore. Këtu përfshihen tabelat për bilancet e gjendjes, bilancet e suksesit, depozitat, kreditë, normat e interesit, kursin e këmbimit, etj.

Tabelat kryesore janë si vijon:

- Pasqyra e korporatave të tjera depozituese (KTD)
- Bilanci i gjendjes së KTD-ve
- Pasqyra e të hyrave të KTD-ve
- Kreditë e KTD-ve - sipas maturitetit
- Kreditë e KTD-ve - sektorët ekonomikë
- Kreditë e KTD-ve - kreditë e reja
- Investimet e KTD-ve në kredi dhe depozita
- Depozitat në KTD - depozitat në euro
- Depozitat në KTD - depozitat në jo euro
- Depozitat dhe huamarrjet e KTD-ve
- Depozitat e KTD-ve - depozitat e reja
- Huamarrjet (borxhet) e KTD-ve
- Letrat me Vlerë të Qeverisë - Normat e interesit dhe shuma
- Kursi devizor
- Sistemi i pagesave
- Rrjeti i KTD-ve dhe numri i të punësuarve

14. [A publikon BQK të dhëna për normat e interesit në kredi dhe depozita dhe ku mund t'i gjej ato?](#)

BQK përpilon të dhënat për normat e interesit në kredi dhe depozita që aplikohen nga bankat komerciale dhe institucionet mikrofinanciare. Në kuadër të depozitave raportohen normat e interesit në llogaritë rrjedhëse, depozitat e afatizuara dhe depozitat e kursimeve, ndërsa kreditë raportohen të ndara sipas qëllimit (kredi investuese, jo investuese, kredi konsumuese, mbitërheqje, etj.). Për më shumë rreth normave të interesit, klikoni [këtu](#).

Për normat e aplikuara nga bankat komerciale, normat e interesit publikohen në këto dy tabela:

[Normat efektive të interesit të KTD-ve në kredi](#)

[Normat efektive të interesit të KTD-ve në depozita](#)

Kurse për normat e aplikuara nga institucionet mikrofinanciare normat e interesit publikohen në këtë tabelë: [Normat efektive të interesit të NTF-ve](#).

15. [Përveç KTD-ve, cilat institucione merren me lejimin e kredive?](#)

Përveç bankave komerciale (KTD), institucionet tjera që merren me lejimin e kredive janë institucionet mikrofinanciare të ashtuquajtura ndërmjetësit tjerë financiar ose institucionet mikrofinanciare. Për dallim nga bankat komerciale, ndërmjetësit tjerë financiar janë të angazhuar në huadhënie në shuma më të vogla. Të gjitha statistikat rreth institucioneve mikrofinanciare mund t'i gjeni në këtë [adresë](#). Tabelat kryesore janë këto:

[Pasqyra e ndërmjetësve të tjerë financiarë](#) (NTF)

[Bilanci i gjendjes së NTF-ve](#)

[Pasqyra e të hyrave të NTF-ve](#)

[Kreditë e NTF-ve - sipas maturitetit](#)

[Kreditë e NTF-ve - sipas sektorëve ekonomikë](#)

[NTF - lizingu](#)

[Aktiviteti i NTF-ve](#)

[Normat efektive të interesit të NTF-ve](#)

[Kreditë e NTF-ve - kreditë e reja](#)

16. [Cili është aktiviteti i ndihmësve financiar?](#)

Aktiviteti i ndihmësve tjerë financiar në Kosovë është kryesisht transferi elektronik i mjeteve. Ndihmësit financiar janë institucionet financiare që nuk lidhen në mënyrë direkte me ndërmjetësimin financiar e që mund të jenë këmbimoret, brokerët , agjentët e ndryshëm, etj. Për më shumë rreth statistikave të ndihmësve tjerë financiar, klikoni [këtu](#). Tabelat kryesore janë këto:

[Pasqyra e ndihmësve financiarë](#)

[Bilanci i gjendjes së ndihmësve financiarë](#)

[Pasqyra e të hyrave së ndihmëve financiarë](#)

17. [Ku mund të gjejë të dhëna për Kompanitë e Sigurimeve](#)

Të dhënat për Kompanitë e Sigurimeve 9psh, bilancin e gjendjes, të suksesit, numrin dhe vlerën e policave kufitare të sigurimit, si dhe të gjitha të dhënat tjera lidhur me kompanitë e sigurimit mund të gjeni në këtë [adresë](#). Tabelat kryesore janë këto:

[Pasqyra e KS-ve](#)

[Bilanci i gjendjes së KS-ve](#)

[Pasqyra e të hyrave të KS-ve](#)
[Aktiviteti i KS-ve](#)

18. [Cfarë nënkuptohet me statistikat të sektorit të jashtëm dhe cilët tregues kryesor përfshijnë këto statistika?](#)

Statistikat e sektorit të jashtëm nënkuptojnë të gjitha të dhënat rrjedhëse dhe të akumuluar të cilat pasqyrojnë raportet ekonomike të rezidentëve të Kosovës (personave fizik dhe juridik) me pjesën tjetër të botës. Disa nga treguesit e statistikave të sektorit të jashtëm janë: eksporti dhe importi i mallrave dhe shërbimeve, remitancat, investimet e huaja direkte, investimet në letra me vlerë, rezervat ndërkombëtare, pozicioni i aseteve dhe detyrime financiare ndërkombëtare, borxhi i jashtëm etj.

19. [Cili është kriteri për të klasifikuar statistikat në kuadër të sektorit të jashtëm?](#)

Në statistika të sektorit të jashtëm regjistrohen transaksionet që rezultojnë nga raportet ekonomike në mes të rezidentëve të Kosovës dhe jo-rezidentëve (pjesës tjetër të botës). Pra kriteri kryesor që për klasifikimin e statistikave në kuadër të sektorit të jashtëm për rezidenca. Çdo transaksion që realizohet midis një rezidenti dhe jo rezidenti tregon raportet ndërkombëtare midis këtyre palëve dhe klasifikohet në kuadër të statistikave të sektorit të jashtëm.

20. [Cka nënkuptohet me rezidentë të Kosovës?](#)

Rezidentët e Kosovës janë persona fizik dhe juridik vendbanimi i përhershëm i të cilëve është në Kosovë. Për të qenë rezidentë i Kosovës një njësi ekonomike duhet të ketë një qendër të interesit ekonomik në Kosovë. Një individë ose ekonomi familjare ka një qendër të interesit ekonomik në Kosovë nëse ai individë ose ekonomi familjare ka qëllim të qëndroj në Kosovë si dhe ka një shtëpi të cilën e konsideron si banim kryesor. Për të bërë më të thjeshtë dallimin midis rezidentëve dhe jo-rezidentëve aplikohet rregulla “një vit”. Në bazë të kësaj individët dhe ekonomitë familjare konsiderohen rezidentë të Kosovës nëse ata qëndrojnë, ose kanë qëllim të qëndrojnë në Kosovë për një vit ose më shumë. Megjithatë, stafi diplomatik, studentët dhe pacientët mjekësor konsiderohen jo-rezidentë pasi qëllimi i tyre për të qëndruar në vend është afatshkurtër.

21. [Cili është burimi i të dhënave për përpilimin e statistikave të sektorit të jashtëm?](#)

Për përpilimin e statistikave të sektorit të jashtëm përdoren një numër i madh i burimeve të të dhënave. Disa nga këto burime që shfrytëzon Departamenti i Statistikës janë: Doganat e Kosovës, Sistemi i Raportimit të Transaksioneve Ndërkombëtare (SRTN), anketat nga kompanitë jo-financiare, institucionet qeveritare, organizatat ndërkombëtare, etj.

22. [Cfarë nënkupton deficieti i llogarisë rrjedhëse të Bilancit të Pagesave të Kosovës?](#)

Deficieti i Llogarisë Rrjedhëse të Bilancit të Pagesave të Kosovës tregon se Kosova në terma të përgjithshëm importon më shumë se sa eksporton mallra dhe shërbime, paguan më shumë se sa arkëton të ardhura nga investimet dhe është pranuese neto e ndihmave nga jashtë.

23. [Cili është burimi i të dhënave për përpilimin e statistikave të tregtisë së jashtme në mallra dhe pse vlera e këtyre statistikave të publikuara nga BQK dallon nga ato të publikuara nga ASK?](#)

Doganat e Kosovës janë burimi kryesor i të dhënave për përpilimin e statistikave të tregtisë së jashtme në mallra. Vlera e këtyre të dhënave të publikuara nga BQK dhe ASK ndryshon për dy arsye kryesore: (1) së pari, BQK për qëllime të bilancit të pagesave bën korrigjime në mbulueshmëri që nënkupton

shfrytëzimin e të dhënave edhe nga burime tjera, siç janë të dhënat për mallrat e blerë në porte nga bartësit (për nevoja të aeroportit); dhe (2) së dyti, BQK bën korrigjime në klasifikim duke përjashtuar shpenzimet e transportit dhe sigurimit nga vlera e importit dhe duke regjistruar kështu në kuadër të bilancit të pagesave vlerën e eksportit dhe importit në bazën f.o.b. (free on bord).

24. [Cili institucion është prodhues zyrtar i statistikave mbi remitancat në Kosovë dhe çfarë burime të të dhënave përdoren për të përpiluar ato?](#)

BQK është prodhues zyrtar i statistikave mbi remitancat në Kosovë. Për përpilimin e remitancave përdoren disa burime të të dhënave. Një nga burimet kryesore janë transferet ndërkombëtare të realizuara nga bankat komerciale që operojnë në Kosovë. Përveç bankave komerciale, burime tjera të të dhënave janë: agjencionet për transfere të mjeteve, Doganat e Kosovës etj. Statistikat mbi remitancat sipas kanale dhe shteteve dërguese, mund t'i gjeni në këtë [adresë](#). Tabelat kryesore janë këto:

[Dërgesat e emigrantëve - sipas kanalave](#)

[Dërgesat e emigrantëve - sipas shteteve](#)

25. [Cili institucion është prodhues zyrtar i statistikave mbi Investimet e Huaja Direkte në Kosovë \(IHD\) dhe çfarë metodologjie përdoret për përpilimin e tyre?](#)

Prodhuese zyrtar i statistikave mbi Investimet e Huaja Direkte në Kosovë (IHD) është BQK. Metodologjia që përdoret për përpilimin e këtyre statistikave është në përputhshmëri me metodologjinë që rekomandon FMN dhe e cila përdoret nga të gjitha vendet (Manuali mbi Statistikat e Bilancit të Pagesave dhe Pozicionit të Investimeve Ndërkombëtare, Udhëzues për përpilimin Investimeve të Huaja Direkt, Udhëzues për përpilimin Anketës së Harmonizuar të Investimeve Direkte). Rrjedhimisht, statistikat mbi IHD-të në Kosovë janë të krahasueshme me të gjitha vendet tjera. Për me shumë rreth metodologjisë së përpilimit të IHD-ve, klikoni [këtu](#). Tabelat kryesore janë këto:

[Investimet e huaja direkte – sipas zërave financiar](#)

[Investimet e huaja direkte - sipas sektorëve](#)

[Investimet e huaja direkte - sipas shteteve](#)

[Investimet e huaja direkte - sipas kriterit gjeografik](#)

26. [Çfarë nënkupton zëri “Gabimet dhe harresat neto” në kuadër të bilancit të pagesave?](#)

Në teori, shuma e hyrjeve në anën e kreditit duhet të jetë e barabarte me shumën e hyrjeve në anën e debitit gjatë një periudhe. Por, në praktikë, meqë disa transaksione mund të mos përfshihen apo për shkak të dallimeve në mbulueshmëri, vlerësim dhe kohës së transaksioneve, nuk ka përputhje të saktë të zërave bilancor. Prandaj, zëri bilancor “gabimet dhe harresat neto” përdoret për të balancuar llogarinë e përgjithshme. Idealisht, vlera e këtij treguesi duhet të jetë relativisht e vogël në raport me vlerën e të gjitha transaksioneve në kredi dhe debi.

27. [Çfarë tregojnë statistikat për PIN \(Pozicioni i Investimeve Ndërkombëtare\)?](#)

Statistikat mbi PIN tregojnë vlerën e aseteve financiare të rezidentëve të Kosovës të cilat janë kërkesa tek jo-rezidentët dhe detyrimet e rezidentëve ndaj jo-rezidentëve. Në pozicionin e investimeve ndërkombëtare përveç transaksioneve rrjedhëse që janë pjesë e bilancit të pagesave, regjistrohen edhe transaksionet tjera, siç janë ndryshimet në asete dhe detyrime financiare si rrjedhojë e ndryshimeve në vlerësim (për shkak të kursit të këmbimit ose ndryshimit të çmimit) si dhe ndryshime tjera. Statistikat rreth PIN mund t'i gjeni në këtë [adresë](#).

28. [Çka përfshihet në statistikat e borxhit të jashtëm të publikuara nga BQK?](#)

Statistikat e borxhit të jashtëm të publikuara nga BQK përfshijnë borxhin publik dhe privat që rezidentët e Kosovës kanë ndaj botës së jashtme. BQK publikon të dhëna për borxhin e jashtëm sipas sektorëve, sipas kreditorëve, planin e kthimit të borxhit të jashtëm, vlerën neto të borxhit (asetet minus detyrimet) të cilat mund t'i gjeni në këtë [adresë](#). Tabelat kryesore janë këto:

[Pozicioni neto i borxhit të jashtëm](#)

[Pozicioni i borxhit të jashtëm bruto](#)

[Borxhi i jashtëm bruto - sipas kreditorëve](#)

[Plani i kthimit të borxhit të jashtëm publik](#)

29. [Ku duhet të drejtoheni për informata shtesë?](#)

Për informata shtesë, ju lutem kontaktoni në Departamentin e Statistikës, BQK

E-mail: statistics@bqk-kos.org